



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada -Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/Ministarstvo Trgovine i Industrije/Ministry of Trade
and Industry
Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

RAPORT - VLERËSIMI I NDIKIMIT
TË
“PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE ”

Prishtinë, 2019

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtesave	2
HYRJA.....	3
1. METODOLOGJIA	5
2. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	6
2.1 Ndërmarrjet përfituese sipas rajonit dhe sektorëve.....	6
2.2 Madhësia dhe rentabiliteti i ndërmarrjes	9
2.3 Trendi i punësimit në vite.....	9
2.4 Trendi i qarkullimit në vite.....	10
2.5 Kapacitetet prodhuese.....	12
2.6 Zhvillimi i produkteve apo shërbimeve	14
2.7 Eksportet.....	15
2.8 Pjesëmarrja në trajnime	17
2.9 Certifikimi i ndërmarrjeve në menaxhimin e cilësisë.....	17
3. PËRFITIMET NGA “PROGRAMI I KIESA PËR ZHVILLIMIN E NVM-ve 2017”	19
3.1 Rezultatet e programit	19
3.2 Programi në të ardhmen	21
4. SFIDAT E NDËRMARRJEVE.....	23
5. PËRMBLEDHJE	24
6. REKOMANDIMET.....	26
7. REFERENCAT.....	27
8. PYETËSORI.....	28

Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
CDP	Programi i KIESA për Zhvillimin e Ndërmarrjeve
DI	Departamenti i Industrisë
DPI	Divizioni për Politika Industriale
ICEP	Rritja e Konkurrueshmërisë dhe Nxitja e Eksporteve
KIESA	Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OMB	Organizatrat për Mbështetje të Biznesit

Hyrje

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes projekti "Rritja e konkurrueshmërisë dhe promovimi i eksportit" (ICEP) i financuar nga BE realizoi një pilot nismë, në nivel të Kosovës, për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në rritjen e aftësisë së tyre konkurruese si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Pikësynimi i përgjithshëm i projektit të konkurrueshmërisë, të financuar nga BE, ka qenë të përmirësoj rritjen ekonomike dhe punësimin në sektorin privat duke fuqizuar aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve kosovare dhe të promovojë integrimin e Kosovës në ekonominë botërore.

Programi për Zhvillimin e ndërmarrjeve (CDP) në kuadër të sektorëve të industrisë ka shënjestruar NMV-të, që janë ndërmarrje të ngritura me motivim të lartë të menaxhmentit, angazhim të qartë dhe kapacitete për të filluar eksportin ose zgjerimin e eksporteve të tyre në tregjet ekzistuese ose përmes hyrjes në tregje të reja.¹

Zbatimi i programit është mbështetur nga projekti tre vjeçar (2016-2018): "Rritja e konkurrueshmërisë dhe promovimi i eksportit" i financuar nga BE (ICEP). Programi është planifikuar të ofrojë mbështetje praktike (duke përfshirë trajnimin dhe mentorimin e menaxhimit) për NVM-të prodhuese kosovare².

Gjatë kohës së thirrjes për aplikim, programi për zhvillimin e ndërmarrjeve (CPD) ka realizuar sesione informuese në rajonet e Kosovës ku përfaqësuesit e kompanive kanë pasur mundësi të informohen më hollësisht lidhur me programin.

Departamenti i Industrisë, respektivisht Divizioni për Politika Industriale, gjatë vitit 2019 ka realizuar monitorimin e projektit "Konkurrueshmëria e NVM-ve", përmes anketimit si dhe vizitave të drejtpërdrejta të 29 NVM-ve përfituese nga programi CDP – projekti ICEP, i realizuar në bashkëpunim me KIESA.

Sektorët përfitues

Programi ka pasur për qëllim të përkrahë 4 sektorë prodhues, si:

- Sektori i drurit;
- Sektori i Plastikës dhe Gomës;
- Sektori i Metaleve dhe
- Sektori i tekstilit, veshjeve dhe lëkurës

¹ <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/0B36EAA6-D5B3-4799-ABC7-B0D3C4010727.pdf>

² MTI, KIESA & ICEP (2019). [online] kiesa.rks-gov.net. Në dispozicion në: <http://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/A6F1EC18-C921-4593-A0C6-9C08F0DB88DA.pdf> [Qasur më 5 qershor 2019]

1. METODOLOGJIA

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të programit është vlerësimi i ex-post (vlerësimi i ndikimit) të programit.

Metodologjia e vlerësimit të programit, e paraqitur në këtë raport, është kryer pasi që janë pranuar dhe analizuar të dhënat pas vizitave të drejtpërdrejta, që janë realizuar me përgjegjësit e 29 ndërmarrje përfituese, të përcjella edhe me plotësimin e pyetësorit.

Pyetësi është hartuar në bazë të aplikacioneve të ndërmarrjeve, ku janë marrë për bazë të dhënat gjatë kohës së aplikimit, të cilat janë krahasuar me të dhënat pas periudhës së aplikimit. Viti 2017, ka qenë viti kur 29 ndërmarrje kanë përfituar nga programi, ndërsa gjatë muajve prill – maj të vitit 2019, janë vizituar ato dhe janë marrë të dhënat për të realizuar vlerësimin e ndikimit të programit.

Tabela 1, ilustron numrin e ndërmarrjeve përfituese sipas sektorëve dhe rajoneve të cilat kanë qenë pjesë e vizitave dhe intervistimit.

Të gjitha të dhënat e prezantuara në këtë raport janë të dhëna të bazuara në burimet primare nga intervista me 29 ndërmarrjeve përfituese, të programit të KIESA-s për zhvillimin e ndërmarrjeve.

Për çështje të konfidencialitetit, emrat e bizneseve nuk janë paraqitur.

2. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Procesi i vlerësimit të ndikimit të “Programi i KIESA për zhvillimin e NVM-ve 2017”, është zhvilluar duke u bazuar në qëllimin e programit.

Përmes vizitave dhe plotësimit të pyetësorëve janë nxjerrë të dhënat si:

- Ndërmarrjet përfituese sipas rajonit dhe sektorëve;
- Rentabiliteti i ndërmarrjeve;
- Produkti ose shërbimi kryesor i ndërmarrjeve;
- Eksportet;
- Trajnimet dhe menaxhimi i cilësisë;
- Përfitimet nga “Programi i KIESA për zhvillimin e NVM-ve 2017”;
- Sfidat e NMV-ve.

Rezultatet e vlerësimit dhe analizës tregojnë zhvillimin e ndërmarrjeve duke identifikuar mangësitë dhe mundësitë për të zhvilluar programe përkrahëse, edhe pse zhvillimi i tyre nuk lidhet drejtpërdrejt me përfitimet nga programi.

Pjesa qendrore e këtij raporti pasqyron të arriturat e programit dhe është pjesa e tretë e prezantuar në këtë raport, “Programi i KIESAs për zhvillimin e NVM-ve 2017”.

2.1.Ndërmarrjet përfituese sipas rajonit dhe sektorëve

Sipas shtrirjes gjeografike ndërmarrjet përfituese kanë qenë nga të 7 rajonet e Kosovës si:

- Prishtinë 9 ndërmarrje;
- Prizren 4 ndërmarrje;
- Ferizaj 6 ndërmarrje;
- Pejë 6 ndërmarrje;
- Gjilan 1 ndërmarrje;
- Gjakovë 1 ndërmarrje;
- Mitrovicë 2 ndërmarrje.

Ndërmarrjet përfituese, sipas sektorëve kanë qenë të dominuara nga përpunimi i drurit duke përfshirë mobilet, të paraqitura në Tabelën nr. 1.


Tabela 1. Numri i ndërmarrjeve përfituese sipas sektorëve dhe rajoneve

Rajonet	Sektori					Numri i ndërmarrje
	Përpunim i i metalit	Përpunimi i drurit përfshirë mobilet	Përpunimi i plastikës/g omës	Tekstil, veshjet	Produktet e lëkurës	
Prishtinë	2	5	2			9
Prizren	1+1		1 + 1		1	4 (1 është metal & Plastikë)
Ferizaj	1+1	4+1	1			6 (1 është dru & metal)
Pejë	1+1	2	1	2		6 (1 është metal dhe plastikë)
Gjilan			1			1
Gjakovë				1		1
Mitrovicë		1	1			2
Total	7	12	6	3	1	29

Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Siç shihet në Tabelën nr. 1, numri i ndërmarrjeve përfituese të projekti ICEP/KIESA është 29, të identifikuar sipas sektorëve industrial. Numri i përfituesve me numër më të madh të ndërmarrjeve është vlerësuar sektori i drurit përfshirë mobilet, i pasuar nga sektori i metalit, ai i plastikës dhe gomës dhe më pas radhitet sektori i tekstilit, veshjes dhe lëkurës.


Figura 1. Përqindja e ndërmarrjeve përfituese sipas sektorëve



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Në Figurën nr. 1, janë pasqyruar ndërmarrjet përfituese sipas sektorëve të shprehur në %, ku dominon sektori i drurit duke përfshirë edhe mobilet me 41.38% të ndërmarrjeve përfituese nga totali i ndërmarrjeve.

Figura 2. Përqindja e ndërmarrjeve përfituese sipas rajoneve



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Sa i përket shpërndarjes së ndërmarrjeve, përfitueseve sipas rajoneve, rajoni i Prishtinës është me numrin më të madh të përfituesve, me 31.03, nga 29 ndërmarrjet përfituese, pastaj vjen rajoni i Pejës dhe rajoni i Ferizajt me nga 20.69% etj.

2.2. Madhësia dhe rentabiliteti i ndërmarrjeve

Ndërmarrjet përfituese të programit kanë prezantuar rritje në kapacitete prodhuese, punësim, qarkullim, shfrytëzim të kapaciteteve prodhuese dhe fitim.

Për të arritur fitim, ndërmarrjet duhet të kenë një menaxhment të mirë i cili rritë produktivitetin duke i stimuluar punëtorët dhe sigurohet që ata janë duke i realizuar punët me përgjegjësi dhe kompetencë. Në përcaktimin e rentabilitetit të ndërmarrjeve ndikojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në kuadër të faktorëve të brendshëm rolin kryesor e ka menaxhimi i ndërmarrjeve, ndërsa faktorët e jashtëm janë më të shumtë në numër dhe nuk varen nga vetë ndërmarrja, si: gjendja ekonomike e një vendi, politika ligjore, sociale, dimensionimi teknologjik, etj.

2.3. Trendi i punësimit në vite

Punësimi është një ndër problemet kryesore, në përgjithësi të vendet në zhvillim dhe në këtë grup të vendeve bënë pjesë edhe Kosova. Siç e shohim edhe nga të dhënat statistikore, zhvillimi i ndërmarrjeve jo domosdo ndikon në rritje të punësimit, marr parasysh faktin se zëvendësimi i teknologjisë mund të rritë produktivitetin dhe e zvogëlon numrin e punëtorëve.

Sipas Raportit të katërt të Observatorit Evropian për NVM, në rritjen e produktivitetit natyrisht paraqitet reduktimi i vendeve të punës në sektorë të veçantë³.

Në pjesën e punësimit të ndërmarrjet e anketuara është vërejtur se ka treguar trend rritje nga viti 2017 në vitin 2018.

Tabela 2 . Numri i ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar rritje të punësimit në vitet 2017 dhe 2018

	Viti 2017	Viti 2018
Rritje	18	20
Njëjtë	4	3
Rënie	3	2
Pa përgjigjeje	4	4
Gjithsej	29	29


Burimi: Përllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Sipas Tabelës nr. 2, në vitin 2017 rritje në punësim kanë deklaruar se kanë pasur 18 ndërmarrje nga gjithsej 29 sa kanë qenë të intervistuar dhe përfitues të projektit, deri sa në vitin 2018 rritje në numër të punësuarve kanë deklaruar 20 ndërmarrje.

³ http://europa.eu/rapid/press-release_IP-96-920_en.htm

Trendi total i punësimit, shprehur në përqindje, është paraqitur në figurën 3.

Figura 3. Trendi i punësimit në vitin 2017 dhe 2018



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Punësimi gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016, ka pësuar ndryshim pozitiv (rritje) për 9.60%, ndërsa në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ndryshimi në rritje të numrit të punësuarve ka qenë për 15.60%. Nëse marrim vitin 2018, atëherë vërejmë se diferenca e trendit në rritje nga viti 2017 ka kaluar për 6%.

Këto të dhëna tregojnë se viti 2018, te ndërmarrjet përfituese të projektit ka pasur një ndryshim pozitiv në rritje të punësimit.

2.4 Trendi i qarkullimit në vite

Një ndër faktorët që tregon se ndërmarrja ka performancë të mirë është edhe qarkullimi, ku menaxhimi i duhur i rrjedhës së parasë ndikon te qëndrueshmëria e NVM-ve. Qarkullimi i mjaftueshëm, mundëson që ndërmarrjet të kenë aftësi pagese dhe mundësi për përdorim të mirë të pagesave financiare.

Qarkullimi te ndërmarrjet përfituese të projektit ka treguar trend rritje nga viti 2016 në 2017 dhe 2017 në vitin 2018.


Tabela 3 . Numri i ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar rritje të qarkullimit në vitet 2017 dhe 2018

	Viti 2017	Viti 2018
Rritje	16	21
Njëjtë	/	/
Ramje	7	2
Pa përgjigjeje	6	6
Gjithsej	29	29

Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Sipas Tabelës nr. 3, në vitin 2017 rritje në vlerë të qarkullimit, kanë deklaruar se kanë pasur 16 ndërmarrje nga gjithsej 29 sa kanë qenë të intervistuar dhe përfitues të projektit. Gjersa, në vitin 2018 rritje në vlerë të qarkullimit kanë deklaruar 21 ndërmarrje, që do të thotë se 5 ndërmarrje më tepër se në vitin 2017.

Figura 4: Trendi i vlerës totale të qarkullimit, shprehur në ndryshim sipas %, në vitin 2017 dhe 2018



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës


Qarkullimi te ndërmarrjet përfituese të programit të “KIESA-s për zhvillimin e ndërmarrjeve”, të pasqyruar në Figurën nr. 4, shprehur në ndryshim nga 2016 në 2017, ka pasur rritje për 2.86%. Ndërsa në vitin 2018 është pasqyruar rritje e lartë në qarkullim, me 22.30%, krahasuar me vitin 2017.

Këto të dhëna tregojnë se viti 2018, te ndërmarrjet përfituese të projektit, ka pasur një ndryshim pozitiv në rritje të vlerës së qarkullimit.

2.5 Kapacitetet Prodhuese

Kapacitetet prodhuese, rrjedhimisht shfrytëzimi i tyre, luan rolin kryesor te ndërmarrjet prodhuese të cilat vazhdimisht duhet t'i përshtatin sistemet e tyre prodhuese për të qëndruar konkurrent në treg.


Figura 5. Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve në vitin 2017 dhe 2018



Burimi: Përllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese te ndërmarrjet e anketuara përfituese të programit të “KIESA-s për zhvillimin e ndërmarrjeve”, sipas Figurës nr. 5, pasqyron gjendjen më të mirë në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Deri sa në vitin 2017 asnjë ndërmarrje nuk ka shfrytëzuar kapacitetet prodhuese mbi 90%, në vitin 2018 shohim se 4.8% e ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar se kapacitetet prodhuese i kanë shfrytëzuar 95% dhe 14.30% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se kapacitetet prodhuese i kanë shfrytëzuar 100%. Nëse marrim krahasimet e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të ndara në grupe, të dhënat tregojnë se 28.7% e ndërmarrjeve në vitin 2017, kanë shfrytëzuar kapacitetet prodhuese deri 50%, ndërsa në vitin 2018, 14.30% e ndërmarrjeve i kanë shfrytëzuar kapacitetet prodhuese deri 50% dhe 85.70% e ndërmarrjeve shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese e kanë mbi 50%.

Figura 6. Mesatarja e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve të anketuara përfituese të programit, sipas viteve



Burimi: Përllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese te ndërmarrjet përfituese të projektit, sipas Figurës nr. 6, në vitin 2017 është 63%, ndërsa në vitin 2018 mesatarja e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese është 69%, ku vërehet një ndryshim në rritje krahasuar me vitin 2017 për 6%.

2.6 Zhvillimi i produkteve apo shërbimeve

Zhvillimi i produktit është ndër faktorët kryesor përmes së cilit ndërmarrjet bëhen më konkurrense në treg. Ndërmarrjet përmes zhvillimit të produktit arrijnë të kultivojnë, mirëmbajnë dhe të rrisin pjesën e tregut të një kompanie, duke përmbushur kërkesat e konsumatorëve.


Edhe pse përkufizimet për “produktin e ri” janë të ndryshme, duke marrë për bazë nivelin e zhvillimit të ndërmarrjeve në Kosovë, ndërmarrjeve iu është parashtruar pyetja në të kuptuarit e definimit sipas Ref.3 si më poshtë.

“Produktet e reja” mund të jenë⁴:

- Produktet që biznesi kurrë nuk ka bërë ose shitur më parë, por që janë marrë në treg nga të tjerët;
- Risitë e produkteve të krijuara dhe të sjella në treg për herë të parë. Ato mund të jenë produkte plotësisht origjinale, ose produktet ekzistuese që keni modifikuar dhe përmirësuar.

Përgjigjet e ndërmarrjeve të cilat kanë futur në prodhim apo shërbim ndonjë produkt të ri gjatë tri viteve të kaluara janë pasqyruar në Figurën nr. 7.

Figura 7. Ndërmarrjet të cilat kanë pasur produkte të reja në prodhim apo shërbim



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

⁴ <https://www.business.qld.gov.au/running-business/growing-business/becoming-innovative/developing-products/new-products>

Siç shihet në Figurën nr. 7, ndërmarrjet që kanë pasur produkte të reja në prodhim apo shërbim gjatë 3 viteve të fundit (2016, 2017 dhe 2018), janë mjaft shpresëdhënëse për një zhvillim stabil të ndërmarrjeve prodhuese në vend.

Nga 29 bizneset e anketuara, 55.17% e bizneseve kanë deklaruar se gjatë këtyre viteve kanë pasur produkte të reja, të cilat janë kërkuar brenda dhe jashtë vendit, ku kryesisht këto produkte prodhohen për tregun e jashtëm. Ndërsa 34.48% e ndërmarrjeve janë deklaruar se nuk kanë zhvilluar produkt të ri, për arsye të ballafaqimit me sfidat e ndryshme, duke filluar nga mungesa e makinerisë e deri te mungesa e fuqisë së kualifikuar punëtore.


Disa nga produktet e reja të cilat ndërmarrjet e anketuara i kanë zhvilluar janë: Profile metalike, Aksesore metalik, Sandviç panele, Prodhim i konstruksioneve metalike, Lavaman nga Druri, Kadë nga Druri, PD-Windows, Kanape dhe Garnitura, Kabllo të tipit NYM 5x16, Kabllo të tipeve të ndryshme H03VH-H, Kabllo të tipeve të ndryshme, Prodhimi i Telit të bakrit i dimensioneve të ndryshme, Kovë Sistem Rrotullues, Lopatë me Brushë për Pastrim, Etiketa Vetë-ngjitëse, Dru 70 mm, Dru 90 mm, Dru/Alumin, Geomembrana, Film i shtrirë për agrikulturë, Kapelë e shtrirë, Geomembrane me tekstil, Këpucë nga lëkura për fëmijë, Rroba të brendshme, Gëzof me lëkurë dhe me Pupla, Përpunim i drurit masiv, Tavolina, Kuzhina, Komoda, Enterier, Dritare dru/alumin, Derë hyrje kundër zjarrit, Aromë freskuese për dhoma, Produktet smart, Ristrukturimi i mobilieve të vjetra.

2.7 Eksportet

Eksportet paraqesin, të gjitha mallrat e prodhuara (produktet/shërbimet) në një shtet tjetër për shitje apo tregti të ardhshme. Ndër komponentët e rëndësishme të ekonomisë së një vendi janë eksportet, pasi shitja mallrave shton prodhimin bruto të vendit prodhues.

Pjesë e anketimit të ndërmarrjeve përfituese nga programi i KIESA për zhvillimin e ndërmarrjeve, ishte shitja brenda vendi dhe eksporti.

Figura 8. Pjesëmarrja e përqindjes së ndërmarrjeve në eksport




Burimi: Përllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Nga gjithsej 29 ndërmarrje përfituese të programit, 88.46% e tyre kanë deklaruar se një përqindje të shitjeve apo produkteve i eksportojnë, deri sa 11.54% kanë deklaruar se të gjitha produktet apo shërbimet i shesin brenda vendit. Vet fakti se 88.46% e ndërmarrjeve përfituese të programit janë ndërmarrje eksportuese tregon se këto ndërmarrje kanë mundësi dhe potencial për të zhvilluar dhe rritur qasjen në tregjet e jashtme.

Trendi i shitjeve në tregun vendor dhe eksport shprehur në përqindje, për vitin 2016, 2017, 2018 dhe planifikimet për vitin 2019/2020 është pasqyruar në Figurën nr. 9.

Figura 9. Shitjet në tregun vendor dhe eksportet



Burimi: Përllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Trendi i eksporteve sipas figurës 9, tregon se ka rritje të eksporteve nga viti në vit. Rritje më të lartë në eksport, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur në vitin 2018. Është karakteristikë të paraqitet edhe planifikimi për vitet 2019/2020, ku në bazë të dhënave të paraqitura në grafik vërehet se ndërmarrjet e anketuara kanë paraqitur të dhëna reale dhe jo ambicioze.

Duhet pranuar faktin se ndërmarrjet kosovare kanë nevojë për përkrahje në rritje të eksporteve, me qëllim që t'iu mundësohet të arrijnë nivelin e ndërmarrjeve që operojnë në ekonomitë e zhvilluara. Rritja e eksporteve ndikon në nxitjen e aktiviteteve ekonomike vendase duke krijuar punësim, prodhim dhe të ardhura.


Vendet ku kryesisht kanë eksportuar ndërmarrjet e anketuara janë: Gjermania, Italia, Franca, Belgjika, Zvicra, Serbia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia, Suedia, Norvegjia, Austria, Anglia, Kroacia, Greqia etj.

2.8 Pjesëmarrja në trajnime

Ndërmarrjet në vazhdimësi duhet të zhvillojnë ose të praktikojnë trajnime për punëtorët e tyre, trajnimet janë të vazhdueshme dhe kurrë nuk përfundojnë, kur dihet se në kohën e zhvillimit të teknologjisë trajnimet janë më se të domosdoshme. Vetë trajnimet janë proces i rritjes së aftësive dhe njohurive të punonjësve për të bërë një punë të veçantë.

Duke u bazuar në atë se anketimi i ndërmarrjeve është zhvilluar kryesisht me ndërmarrje të cilat kanë një strukturë të mirë organizative, atëherë edhe rezultatet e pjesëmarrjes në trajnime janë të kënaqshme, të cilat janë pasqyruar në Figurën nr. 10.

Figura 10. Përqindja e ndërmarrjeve të anketuara të cilat kanë qenë pjesë e trajnimeve



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Duke u bazuar në ndryshimet e ndodhura, sipas Figurës nr. 10, pjesëmarrjen e stafit në trajnime e kanë deklaruar 75% e ndërmarrjeve të anketuara. Kjo ndërlidhet me Figurën nr. 6, e cila tregon se 55% e ndërmarrjeve kanë futur në prodhim produkte të reja, ku ndryshimet e zhvilluara në teknologji dhe metodave tjera të punës të çfarëdo niveli, kërkojnë trajnime për të përballuar këto ndryshime.


2.9 Certifikimi i ndërmarrjes në menaxhim të cilësisë

Certifikimi i ndërmarrjeve në menaxhim të cilësisë ndikon në bërjen e një sektori ekonomik apo edhe vendi më konkurrues.

Menaxhimi i cilësisë mund të identifikohet si i dyanshëm, mjet konkurrues sepse ka përmirësuar cilësinë e produktit (kënaqësinë e konsumatorit) dhe kostot e reduktuara (efikasiteti) në të njëjtën kohë.⁵

Zakonisht brenda vet ndërmarrjeve në Kosovë, certifikimi i ndërmarrjeve në menaxhimin e cilësisë është kuptuar i domosdoshëm në kohën kur ndërmarrjet kanë filluar të eksportojnë dhe janë ballafaquar me kërkesat e certifikimit. Megjithatë, jo çdoherë dhe varësisht prej vendit ku eksporton kërkohen certifikatat e menaxhimit të cilësisë.

Figura 11. Certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë?



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Se sa ndërmarrjet përfituese të projektit janë të certifikuara me sistemin e menaxhimit të cilësisë tregon Figura nr.11, ku 57.69% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se janë të certifikuara me sistemin e menaxhimit të cilësisë. Kjo ndërlidhet me figurën 8, ku 88.46% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se eksportojnë.

⁵ https://repositorio.cepal.org/bitstream/handle/11362/4688/1/S9700133_en.pdf

3 Përfitimet nga “Programi i KIESA-s për zhvillimin e NVM-ve 2017”

Gjatë fazës së inicimit dhe zhvillimi të projekteve, përfitimet duhet të identifikohen dhe të specifikohen, me qëllim që pas implementimit të projektit, të mund të bëhet vlerësimi i ndikimit të projektit.

Projektet e këshillimit, si në rastin e “Programi i KIESA për zhvillimin e NVM-ve 2017”, janë mjaft komplekse për t’i vlerësuar për arsye se ka perspektiva të shumta për të kuptuar se cili është suksesi.

Në fillim të projektit, duhet të përcaktohen objektivat dhe indikatorët përmes të cilëve duhet të maten rezultatet e realizimit të objektivave dhe përcaktimi i afatit kohor kur mund të arrihen rezultatet në realizimin e objektivave të projektit.

Sipas Letts, Ryan dhe Grossman (1998), tre rezultatet e përgjithshme përfshijnë: 1) ndihmë organizatës për të bërë atë që tashmë e bën, por më mirë; 2) përmirësimin e aftësisë për t’u rritur; dhe 3) përmirësimin e aftësisë për të ndryshuar.⁶


3.1 Rezultatet e programit

Rezultatet e projektit “Programi i KIESA për zhvillimin e NVM-ve 2017”, janë matur duke u marrë për bazë të dhënat e aplikimeve të ndërmarrjeve përfituese, të cilat janë krahasuar me të dhënat e deklaruara nga ndërmarrjet pas periudhës së aplikimit.

Ndër fushat kryesore, nga të cilat ndërmarrjet kanë përfituruar dhe janë deklaruar se kanë pasur sukses janë: sistemi i menaxhimit të cilësisë, zhvillimi i produktit, efikasiteti i prodhimit, vlerësimi dhe promovimi për eksport, avancim në zhvillimin e marketingut, hulumtim i tregut etj.

Në Figurën nr. 12 është prezantuar deklarimi i bizneseve, nëse programi ka pasur apo jo ndikim në rezultatet e tyre, apo nëse janë realizuar pritjet e tyre.

Figura 12. Përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë dhënë përgjigjeje në suksesin e programit




Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

⁶ <https://managementhelp.org/misc/defining-success.pdf>

Nga gjithsej 29 ndërmarrjet përfituese të projektit, 65.52% kanë deklaruar se projekti ka qenë i suksesshëm, ndërsa 24.14% kanë deklaruar se projekti nuk ka qenë i suksesshëm. Ndërsa 3 ndërmarrje, apo 10.34% nuk kanë ofruar përgjigje, të cilat gjatë vizitës është vërejtur se nuk janë ndarë të kënaqur me projekt dhe nuk kanë ofruar të dhëna. Ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar mos suksesin e ndërmarrjes, si arsyetim kryesor kanë deklaruar se ekspertët kanë ofruar diçka tjetër dhe jo atë çka kanë kërkuar në aplikim, problem tjetër ka qenë mos ofrimi i njohurive praktike lidhur me këshillimin e ofruar.

Për të arritur më saktë, nëse projekti ka arritur rezultatet e pritura te ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar se projekti ka qenë i suksesshëm, është vazhduar me nën pyetjen “Nëse po, përshkruani suksesin duke specifikuar në vlera ose përqindje rezultatet (të arriturat) pas përfundimit të projektit KIESA/ICEP”.

Figura 13. Përshkruani suksesin duke specifikuar në rezultatet (të arriturat) në përqindje



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Nga gjithsej 65.52% të ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se programi ka pasur sukses, 44.82% e tyre kanë deklaruar fushat specifike dhe suksesin e kanë vlerësuar 100% të arritur, ndërsa 3.45% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se projekti ka pasur sukses në 80% të realizimit të kërkesave; 50% të realizimit të kërkesave, projekti i ka arritur te 3.45% të ndërmarrjeve dhe nën 50% apo më saktësisht 20% – 30 % e realizimit të kërkesave programi i ka arritur te 6.90% të ndërmarrjeve. Duhet cekur se 6.90% e ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se programi ka pasur sukses, nuk kanë ofruar përgjigje për rezultatet e arritura të pritshmërisë nga projekti dhe nuk kanë pasur njohuri të identifikojnë fushat e përfitimit nga e cila mund të konkludojmë se nuk kanë arritur ndonjë rezultat të pritshëm nga projekti.


3.2 Programi në të ardhmen

Me qëllim të vlerësimit të projektit në pjesën në vazhdim, raporti është orientuar të ofrojë përgjigje në pyetjet:

- A mund të vazhdojmë edhe më tej me projektin dhe të japim rezultate më të mëdha?
- A duhet të mos implementohet ky projekt apo duhet të implementohet ndonjë projekt i ngjashëm në të ardhmen?

Në Figurën nr. 14, është pasqyruar rezultati i ofrimit të përgjigjeve, nëse ndërmarrjet përfituese e shohin të nevojshme vazhdimin e këtij programi.

Figura 14. Përgjigjet e ndërmarrjeve në vazhdimin e projektit




Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Kërkesat për projekte të tilla janë për t'u marrë në konsideratë për ndërmarrjet kosovare. Sipas Figurës 14, 75.86% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se ky projekt është i nevojshëm të vazhdohet, përderisa 13.79% kanë deklaruar se nuk e shohin të arsyeshme vazhdimin e një projekti të tillë dhe 10.34% e ndërmarrjeve nuk kanë ofruar përgjigje. Nëse krahasojmë Figurën nr. 14 me Figurën nr. 12, atëherë vërejmë se rreth 10% e ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se projekti nuk ka qenë i suksesshëm, kanë shpresë dhe kërkojnë vazhdimin e programit me plotësime dhe ndryshime.

Për të sqaruar edhe më tutje, është vazhduar me 75.86% të ndërmarrjeve të cilat kanë deklaruar se duhet të vazhdohet me programin, ku është parashtruar nën pyetje, *Nëse Po, Pse dhe cila do të ishte kërkesa specifike e juaja?*

Figura 15. Përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë specifikuar kërkesat



Burimi: Përlllogaritja e vetë autorit, të dhënat e anketës

Sipas Figurës nr. 15, vërehet se 65.52% e ndërmarrjeve përfituese të programit, janë të interesuara që të vazhdon programi me disa ndryshime dhe njëherit kanë specifikuar fushat e projektit.

Propozimet nga bizneset për ndryshimin e këtij programi janë të ndryshme duke renditur fushat si: hulumtimi i tregjeve të huaja dhe eksporti, zhvillimi i prodhimit dhe produkteve të reja, certifikimi i produkteve, dizajni i produkteve etj.

Bizneset përfituese të cilat kërkojnë të vazhdohet me programin kanë specifikuar kërkesat për ndryshim të programit duke u fokusuar në:

- Ekspertët të jenë të fushës përkatëse (sipas kërkesave të biznesit);
- Para se të përcaktohen ekspertët, bizneset kërkojnë të kenë CV-në dhe referencat e ekspertit për projektet e ngjashme të përfunduar;
- Ekspertet të jenë praktik dhe më pak teorik;

Edhe pse projekti nuk ka realizuar nivelin e pritshmërisë së rezultateve, në bazë të gjeturave vërehet se programi ka qenë shumë i përshtatshëm për bizneset të cilat kanë një strukturë të mirë organizative, janë eksportuese dhe kanë synim zgjerimin e eksportit.

4 Sfidat e ndërmarrjeve

Identifikimi i problemeve (sfidave) të ndërmarrjeve është shumë e rëndësishme për të arritur deri te zgjidhja e problemit. Identifikimi i problemeve të ndërmarrjeve, kërkon trajtim të veçantë dhe është mjaft i vështirë për t'u identifikuar edhe nga vetë ndërmarrja, ku ndonjëherë problemet në ndërmarrje kalojnë pa u vënë re derisa të vijë deri te dëmi.

Të gjitha bizneset e anketuara, kanë deklaruar lloje të ndryshme të problemeve, të cilat kërkojnë mbështetjen institucionale për tejkalimin e këtyre sfidave, e disa nga sfidat janë:

1. Mungesa e puntorëve të kualifikuar;
2. Normat e larta të interesit;
3. Konkurrenca jolojale;
4. Mungesa e teknologjive prodhuese;
5. Problemi me Kodet Doganore.

5. Përmbledhje

- Vlerësimi i ndikimit të programit – ky vlerësim është kryer në të gjitha ndërmarrjet përfituese të programit të KIESA për zhvillimin e ndërmarrjeve (2016-2018), në sektorin e drurit, plastikës dhe gomës, metaleve, tekstilit dhe lëkurës;
- Punësimi gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016 ka pësuar ndryshim pozitiv (ritje) për 9.60%, ndërsa në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 ndryshimi në ritje të numrit të punësuarve ka qenë për 15.60%.
- Qarkullimi, te bizneset përfituese të programit të “KIESA-s për zhvillimin e ndërmarrjeve”, të pasqyruar në figurën nr. 3, shprehur në ndryshim nga 2016 në 2017 ka pasur ritje për 2.86%, ndërsa në vitin 2018 është pasqyruar ritje e lartë në qarkullim me 22.30% në ndryshim krahasuar me vitin 2017.
- Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese te ndërmarrjet përfituese të projektit - sipas figurës nr. 5, në vitin 2017 është 60%, ndërsa në vitin 2018 mesatarja e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese është 64%.
- Zhvillimi i produkteve apo shërbimeve - 55.17% e bizneseve kanë deklaruar se gjatë këtyre viteve kanë pasur produkte të reja, të cilat janë kërkuar brenda dhe jashtë vendit, ku kryesisht këto produkte prodhohen për tregun e jashtëm, ndërsa 34.48% e ndërmarrjeve janë deklaruar se nuk kanë zhvilluar produkt të ri për shkak të sfidave të ndryshme që ballafaqohen nga mungesa e makinerisë e deri te mungesa e fuqisë punëtore.
- Eksportet, 88.46% e tyre kanë deklaruar se një përqindje të shitjeve apo produkteve i eksportojnë, deri sa 11.54% kanë deklaruar se të gjitha produktet apo shërbimet i shesin brenda vendit.
- Trajnime, 55% e ndërmarrjeve kanë futur në prodhim produkte të reja, ndërlidhet me atë se ndryshimet e zhvilluara në teknologji dhe metodave tjera të punës të çfarëdo niveli kërkojnë trajnime për të përballuar këto ndryshime.
- Certifikimi me sistemin e menaxhimit të cilësisë - 57.69% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se janë të certifikuara me sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Përfitimet nga “Programi i KIESA për zhvillimin e NVM-ve 2017”, 65.52% kanë deklaruar se projekti ka qenë i suksesshëm, 24.14% kanë deklaruar se projekti nuk ka qenë i suksesshëm, ndërsa 3 ndërmarrje apo 10.34% nuk kanë ofruar përgjigje. Të dhënat tregojnë se 44.82% i kanë deklaruar fushat specifike dhe suksesin e kanë vlerësuar 100% të arritur, pastaj 3.45% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se projekti ka pasur sukses në 80% të realizimit të kërkesave, 50% të realizimit të kërkesave projekti i ka arritur te 3.45% e ndërmarrjeve dhe nën 50% apo më saktësisht 20% – 30 % e realizimit të kërkesave, programi i ka arritur te 6.90% e ndërmarrjeve.
- Vazhdimi i projektit - 65.52% e ndërmarrjeve përfituese të projektit, janë të interesuara të vazhdon projekti me disa ndryshime, të cilat njëherit dhe kanë specifikuar fushat e projektit.
- Bizneset përfituese të cilat kërkojnë të vazhdohet me projektin kërkojnë ndryshim të projektit duke u fokusuar në: ekspertët të jenë të fushës përkatëse (sipas kërkesave të biznesit); para se të përcaktohen ekspertet, bizneset kërkojnë të kenë CV dhe referencat e

ekspertit për projektet e ngjashme të përfunduar; ekspertët të jenë praktik dhe më pak teorik.

- Problemet kryesore të prezantuara nga ndërmarrjet e anketuara janë; mungesa e punëtorëve të kualifikuar, normat e larta të interesit, konkurrenca jolojale, mungesa e teknologjive prodhuese, problemi me kodet doganore.

6. Rekomandimet

- Para hartimit, apo plotësim ndryshimit të projekteve, të realizohen takime me bizneset e industrive të targetuara për përkrahje;
- Programet apo projektet të hartohen me qëllimin, objektivat dhe indikatorë të matshëm dhe real;
- Ekspertët të jenë të fushës përkatëse (sipas kërkesave të biznesit);
- Para se të zgjedhën ekspertët, të konsultohen ndërmarrjet duke i njoftuar me CV-të dhe referencat e ekspertit për projektet e ngjashme të përfunduara;
- Të njoftohen ndërmarrjet se këshillimet duhet të shfrytëzohen për përfitim sipas kërkesës dhe nevojës së ndërmarrjes;
- Të njoftohen ndërmarrjet për të drejtat dhe obligimet e tyre;
- Ekspertët të jenë praktik dhe më pak teorik;
- Të monitorohet procesi i ofrimit të këshillimit gjatë fazës së realizimit.

Rekomandimi përfundimtar, në bazë të të gjeturave, tregon se duhet të vazhdohet me programe të tilla por i cili duhet të ketë plotësime dhe ndryshime të programit sipas pikave të rekomanduara më lartë, duke u fokusuar te ndërmarrjet me një strukturë të mirë organizative dhe që janë në fazën e rritjes së eksporteve.

7. Referencat

- MTI, KIESA & ICEP (2019). [online] kiesa.rks-gov.net. I mundshëm në: <http://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/A6F1EC18-C921-4593-A0C6-9C08F0DB88DA.pdf> [Qasur më 5 qershor 2019]
- Europa.eu. (2019). *European Commission - PRESS RELEASES - Press release - CHRISTOS PAPOUTSIS: 'EUROPE IS WORLD LEADER IN ENTERPRISE CULTURE'*. [online] I mundshëm në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-96-920_en.htm [Accessed 10 Jul. 2019].
- Business.qld.gov.au. (2019). *New product development | Business Queensland*. [online] I mundshëm në: <https://www.business.qld.gov.au/running-business/growing-business/becoming-innovative/developing-products/new-products> [Qasur më 10 korrik 2019].
- Repositorio.cepal.org. (2019). [online] I mundshëm në: https://repositorio.cepal.org/bitstream/handle/11362/4688/1/S9700133_en.pdf [Qasur më 28 qershor 2019].
- Managementhelp.org. (2019). [online] I mundshëm në: <https://managementhelp.org/misc/defining-success.pdf> [Qasur më 27 qershor 2019].

Pyetësor

Informatë:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Departamenti i Industrisë / Divizioni për Politika Industriale, me qëllim të hartimit të politikave industriale për zhvillimin e ndërmarrjeve prodhuese, analizon rezultatet e dala nga programet e realizuara dhe propozon zhvillimin e politikave, përmes programeve përkrahëse për mbështetjen e ndërmarrjeve.

Duke plotësuar këtë formular, ju ndihmoni në zhvillimin e programeve përkrahëse për ndërmarrjet në Kosovë.

Ju lutem të plotësoni me korrektësi këtë pyetësor.

Ju Faleminderit

1. Emri i ndërmarrjes dhe regjistrimi

Emri i plotë ligjor i ndërmarrjes:

Numri i regjistrimit të biznesit:

Viti i themelimit të ndërmarrjes:

2. Adresa e ndërmarrjes

Komuna:

Rruga:

Numri i telefonit:

Email:

Ueb faqja:

3. Veprimtaria kryesore e ndërmarrjes

Lutemi të tregoni sektorin industrial të Ndërmarrjes suaj:

- ☐ Përpunimi i metalit
- ☐ Përpunimi i drurit, përfshirë mobiljet
- ☐ Përpunimi i plastikës/gomës
- ☐ Tekstili, veshjet
- ☐ Produktet e lëkurës
- ☐ Tjetër (lutemi të përcaktoni)

Lutemi të tregoni veprimtarinë kryesore në sektor:

- ☐ Prodhimi
- ☐ Shitja me shumicë
- ☐ Shitja me pakicë
- ☐ Shërbimet
- ☐ Tjetër (lutemi të përcaktoni):

4. Madhësia dhe rentabiliteti i ndërmarrjes

Numri i punëtorëve me orar të plotë (mesatarja vjetore)

2016:

2017:

2018:

Qarkullimi (në €):

2016:

2017:

2018:

- A ka realizuar fitim tregtar ndërmarrja juaj?	2016: Po ☐ Jo ☐	2017: Po ☐ Jo ☐	2018: Po ☐ Jo ☐

5. Produkti ose shërbimi kryesor

Luteni të përshkruani produktet ose shërbimet tuaja:

6. Prodhimi

6. a) Shfrytëzimi i kapaciteteve të prodhimit

2016: % të kapaciteteve	2017: % të kapaciteteve	2018: % të kapaciteteve
Lënda kryesore e parë		Vendi i origjinës

6.b) A ka zhvilluar ndërmarrja ndonjë produkt / shërbim të ri në 3 vitet e kaluara?

Po ☐ Jo ☒

Nëse Po, ju lutem specifikojë produktet apo shërbimet.

2016	2017	2018	Parashikimet për vitin 2019/2020

6.c) A eksporton produkte apo shërbime ndërmarrja juaj? Po ☐ Jo ☐

Nëse Po, ju lutem trego për vendet dhe % e eksportit.

Cilat janë vendet ku keni Eksportuar?	Shitja %
a.	
b.	
c.	
d.	
e.	

6.d) Pjesëmarrja, Shitja dhe Eksporti

	2016	2017	2018	Pritja 2019/2020
Gjithsej shitja €:				
% e shitjes në tregun vendor				
% në tregjet e eksportit				

7. Trajnimet	
7.a) A ka qenë dikush nga ndërmarrja pjesë e ndonjë trajnimi? Po ☐ Jo ☐ <i>Nëse Po, ju lutem trego për organizatat e trajnimit dhe fushën e trajnimit.</i>	
Institucioni / organizata e shërbimit të trajnimit	Fusha e trajnimi
a.	
b.	
c.	

7.b) A ka qenë dikush nga ndërmarrja pjesë e ndonjë trajnimi në menaxhimin e cilësisë? Po ☐ Jo ☐ <i>Nëse Po, ju lutem trego për organizatat e trajnimit dhe fushën e trajnimit.</i>	
Institucioni / organizata e shërbimit të trajnimit	Fusha e trajnimi
a.	
b.	
c.	

8. Sistemi i menaxhimit të cilësisë	
8 a) A është certifikuar sistemi i juaj i menaxhimit të cilësisë? Po ☐ Jo ☐ <i>Nëse Po, ju lutem trego vitin dhe llojin e certifikimit.</i>	
Viti në të cilin është certifikuar	Standardi (lloji i certifikimit)

9. Programi i KIESA-s për Zhvillimin e Ndërmarrjeve	
9.a) Lloji i shërbimit që keni përfituar:	
1.	
2.	
3.	
9.b) A ka qenë i suksesshëm programi për Shërbimin Këshillimor? Po ☐ Jo ☐	

Nëse po, përshkruani suksesin duke specifikuar në vlera ose përqindje rezultatet (të arriturat) pas përfundimit të projektit KIESA/ICEP.
a.
b.
c.
d.
e.

9.c) A është e nevojshme për ndërmarrjen tuaj, zhvillimi i këtij programi? Po ☐ Jo ☐ Nëse Po, Pse dhe cila do të ishte kërkesa specifike e juaja?

9.d) Çka do të kishit propozuar, të ndryshonim në këtë program, çoftë edhe ndonjë program krejtësisht tjetër?

10. Sfidat
10.a) A ballafaqohet ndërmarrja juaj me sfida në zhvillim të biznesit? Po ☐ Jo ☐ Nëse Po, ju lutëm përmendi disa nga sfidat apo problemet
a.
b.
c.

Ju faleminderit për kohën dhe bashkëpunimin tuaj!